



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:113579

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407253

C.nr.1048/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.K., Q.K., M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, A.P.K., D.K.R., Prizren, të cilin e përfaqëson A.B. nga Prizreni, kundër të paditurit G.S. nga fshati..... Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 75.58 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R.K., Q.K., M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, A.P.K., D.K.R., Prizren, për shkak të kompensimit të dëmit, me të cilën ka kërkuar që të "OBLIGOHET i padituri G.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, që paditësit, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 75.58 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita kur është shkaktuar dëmi deri në marrjen e aktgjykimit si dhe t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë".

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R.K., Q.K., M.B.P. dhe Zhvillimit Rural, A.P.K., D.K.R., Prizren, të cilin e përfaqëson A.B. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit G.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 75.58 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, përfaqësuesi i palës paditëse, me parashtrësën C.nr.1048/2021 e datës 28.02.2024, ka njoftuar gjykatën se tërheqen nga kërkesëpadia në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që i padituri ka paguar në tërësi obligimin në shumë prej 75.58 dhe kamatën ligjore në shumë prej 12.09 euro, në shumën e përgjithshme prej 87.67 euro.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, në përputhje me nenin 149 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:113579
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05407253

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1048/2021, datë 04.03.2024

Gj y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.